

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Raif Fazliu me sekretaren juridike Mejreme Uka, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit H. M. nga fshati K. Komuna e Vitisë, kundër të paditurve D. V.-K., D. D.Xh. dhe D. P. që të tre ishin nga Vita tani me adresë të panjohur, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm M. A..avokat në Viti, baza e kontestit vërtetim i drejtës së pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 01.08.2017 shpall këtë:

### A K T G J Y K I M

**I. MIRATOHET** kërkesëpadia e paditësit H. M... nga fshati K... Komuna e Vitise, dhe **i njihet** e drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale nr. xxxx, me sipërfaqe prej xxxm<sup>2</sup>, e regjistruar në emër të D.. V... , ngastra kadastrale nr.xxx, me sipërfaqe prej xxx m<sup>2</sup>,në pronësi të D.. P. dhe ngastra nr.xxx me sipërfaqe prej xxx m<sup>2</sup> në pronësi të D. V. dhe D. në ZK Viti, **në bazë të mbajtjes**.

**DETYROHEN** të paditurit, D. V.-Ko., D. D.-Xh.dhe D. P.që të tre ishin nga Vita tani me adresë të panjohur, në Republikën e Serbisë t'ia njohë të drejtën e pronësisë paditësit H. M. dhe ta durojnë që ngastrat e lartpërmendur t'ia regjistrojnë në emrin e vet.

**Ky aktgjykim** për Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë, paraqet bazë, që në regjistrat kadastralë të bëhet ndryshimi.

**II.** Shpenzimet e procedurës do t'i heq paditësi.

### A r s y e t i m

Paditësi në gjykatë kishte paraqitur padi me datë xxxxx dhe kishte kërkuar nga gjykata që t'i njihet e drejta e pronësisë në ngastrat xxx xxxx dhe xxx, gjykata të paditurve nuk iu kishte dërguar padinë në pergjigje, pasi që nuk iu dihej adresa.

Në seancën përgatitore me datë xxxx paditësi, H.(A.) M., kishte mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykatës që të paditurve ish nga Vitia t'iu caktohet një përfaqësues i përkohshëm, ku gjykata kishte vendosur duke caktuar përfaqësuesin e përkohshëm për të paditurit, M..A.avokat në Viti.

Paditësi kishte propozuar caktimin e një eksperti të gjeodezisë dhe së bashku me të gjykata të del në vendin e ngjarjes për të identifikuar dhe përkufizuar ngastrat kontestuese.

Ai më tej kishte shtuar se në vitin xxx i kishte blere këto ngastra, nga të paditurit me një shume prej xxxx marka gjermane, përmes kontratave gojore ku prezent kishin qene edhe dëshmitaret Gj. T.,M. M. dhe D. Z, dhe po ashtu kishte theksuar se nga kjo kohe ishte në shfrytëzim të pandërprere të këtyre parcelave pa u penguar nga askush.

Në vendin e ngjarjes në Viti me xxxx, gjykata kishte konsultuar se ngastra kontestuese xxxx0 shfrytëzohet nga paditësi H. M.. e cila ishte e mbuluar me zhavor prej viti xxxxx, ndërsa ngastrat xxx dhe xxx ishin të mbjellura me kultur gruri të punuara nga vet paditësi pa u penguar nga askush.

Përfaqësuesi i përkohëshëm i të paditurit av.M. A.nuk e kishte kundërshtuar identifikimin dhe përkufizimin që kishte bërë eksperti gjeodet për ngastrat në fjalë, ndërsa ia kishte lën gjykatës të vendosur bazuar në provat që posedon gjykata dhe si dhe dëshmine e dëshmitarit.

Në seancën kryesore të datës xxx paditësit kishte mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, si dhe deklarimeve nga seancat e kaluara, po ashtu kishte deklaruar se nuk ka vërejtje për ekspertizen e ekspertit gjeodet dhe kishte propozuar që të degjohet dëshmitari Gj. T.në mënyre që të bindet gjykata se vërtet ka ndodhur ky transkasion ndërmjet Babait tim A.. në prezencen time si dhe të paditurve në fjalë.

Në fund kishte deklaruar se kjo palujtshmeri në ditet e sotme llogaritet të ketë vleren diku rreth 18,000 euro.

Përfaqësuesi i përkohëshëm i të paditurit av. M. A., nuk e kishte kundërshtuar propozimin e paditësit për dëgjimin e dëshmitarit.

Dëshmitari Gj.T..kishte deklaruar se me paditësin janë kusherinjë në shkallë të pestë në vijë të gjakut, ka qenë dëshmitar kur janë blerë keto parcela nga vet paditesi dhe babai i tij A.. të cilët e kishin paguar çmimin kontraktues dhe kishin hy në posedim të pandërpre që nga ajo kohe pra që nga viti xxxx, dhe se në atë kohe çmimi kontraktues ka qenë mjaftë i lartë çka do të thotë se edhe shitësit ishin të kënaqur me çmimin e kontraktuar. Po ashtu dëshmitari u përgjigj edhe në pytjen e përfaqësuesit të përkohshëm se a ishte penguar paditësi nga ndonje persone në shfrytëzimin e këtyre palujtshmerive përgjigjeja nga dëshmitari ishte se asnjëher nga askush nuk ishte penguar në shfrytëzimin dhe posedimin e këtyre ngastrave në fjalë.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 8, të LPK-së, vlerësoi provat veç e veç dhe si tërësi. Gjykata kishte lexuar dhe shtjelluar këto prova, si çertifikata e prones me nr.xxxx e dates xxxx me ngastren xxx ,çertifikata e prones xxx e dates xxxx per ngastren xxxx,çertfikata xxx e dates xxxxper ngastren xxxx, pergjigja e AKP-s nr xxxx/fh e dates xxxx pergjigja e Statcionit Plocor ne Viti e dates xxxxx dhe eskpertzia e ekspertit gjeodet T. N. e dates xxxx. Palët pa vërejtje në provat e lexuar.

Në fjalën përfundimtare paditësi, H. M. kishte kërkuar që gjykata t'ia njuh të drejten e pronsisë për ngastrat kontestuese, pasi që të njejtat i shfrytzojnë që nga viti xxx pa u penguar nga askush.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i përkohëshëm i të paditurit, av. M. A.kishte deklaruar, pas mbajtjes se disa seancave gjyqesore dhe pas administrimit te gjitha provave i propozojë gjykates, qe lidhur me kerkespadine e paditesit H.M.te vendos ne baze te bindjes se lire dhe ne baze te gjitha provave te cilat gjindet ne shkresat e lendes te bazura ne te gjitha konditat ligjore qe jane ne fuqi.

Provat: Gjykata ka vërtetuar se në mes paditësit H. M. dhe të paditurve D. .K.D. D.a-Xh.dhe D.P., kishte egzistuar raporti juridik, i cili edhe pse jo i lidhur në formën e shkruar, ai ka prodhuar efekt juridik, me faktin se paditësi ka hy ne posedim në të njejten palujtshmeri, te cilen edhe e mban më tej pa u penguar nga askush.

Gjykata për tërë këtë raport juridik mes palëve ndërgjyqëse u shërbye me të drejtën materiale e cila ishte në fuqi gjatë krijimit të këtyre raporteve, siç është neni 28, i LMD-së, sepse vullneti i palëve ka fuqi detyrimi dhe është mbi ligjin.

Andaj, gjykata duke u bazuar në gjitha këto prova dhe fakte të pakontestueshme, duke qenë e pavarur në vendosje miratoi kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet e procedurës do t'i barti paditësi H. M., neni 453, i LPK-së.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI**

**C.nr.375/2015**

**Më. 01.08.2017**

Sek. Juridike  
Mejreme Uka

Gj y q t a r i,  
Raif Fazliu

**UDHËZIMI PËR MJETIN JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimi të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.